



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; [kqz.sekretariati@kqz-ks.org](mailto:kqz.sekretariati@kqz-ks.org); [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

### **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 07**

**Datë:** 11. 02. 2020. Ora: 14:30

**Vendi:** Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

**Kryesues i mbledhjes:** Alim Rama, anëtar i KQZ-së

**Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ:** Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Artan Asllani.

**SKQZ:** Ylli Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

**Përkthyese:** Argjina Misini

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: Alim Rama, kryesues i mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Aktivitetet e ZRPP-së;**

-Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike, për zgjedhjet e parakohshme për kryetar Komune në Podujevës

**3. Raport i Këshillave;**

**-Këshilli për Çështje Ligjore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë

**4. Të ndryshme.**

---

- 1. Hyrje: Alim Rama, kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

**Alim Rama:** Në mungesë të kryetares, unë do ta udhëheqë mbledhjen e sotme! Konstatoj që kemi kuorum, jemi nëntë anëtarë, para jush është edhe rendi i ditës. Kemi pas kohë ta shqyrtojmë...! Jeni të pajtimit, apo keni ndonjë sugjerim...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.*

## **2. Aktivitetet e ZRPP-së**

Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike, për zgjedhjet e parakohshme për kryetar Komune në Podujevës.

**Ylli Buleshkaj:** Pika e radhës është e zakonshme që zakonisht, shqyrtojmë pesë ditë mbas shpalljes së zgjedhjeve. Pra, është obligim ligjorë! Sipas listës së parë të cilën e kemi pranuar nga Agjensiioni i Regjistrat Civil (ARC), në komunën e Podujevës të drejtë votimi sipas listës, kanë: 86 866 votues. Legjislacioni ynë parasheh që subjektet për secilin votues, mund të shpenzojnë 0.50 cent, ndërsa llogaritja i bie që të gjitha subjektet politike që do të janë konkurrente për të marrë pjesë në zgjedhje me kandidatin e tyre për kryetar komune, mund të shpenzojnë në maksimum: 43 433 euro.

Kjo, tha z. Buleshkaj, është një llogaritje e thjeshtë dhe është rregull që ne duhet ta aprovojmë...! Subjektet politike, nuk duhet ta kalojnë këtë shumë dhe, rekomandojmë që ta aproponi.

*Anëtarët e KQZ-së, unanimisht miratuan vendimin për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike, për zgjedhjet e parakohshme për kryetar Komune në Podujevës.*

## **3.Raport i Këshillave**

### **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë

**Arianit Elshani:** Këshilli, ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevës dhe se, Pajtim Bala, e zëvendëson z. Fitim Haziri. Këshilli, rekomandon që KQZ ta miratojë këtë zëvendësim.

**Alim Rama:** A ka ndokush vërejtje. Nëse jo, kush është për...?

Konstatoj se, KQZ unanimisht e miraton këtë rekomandim.

## **4.Të ndryshme**

**Eshref Vishi:** Unë e ngris kujdesin e publikimit në Ueb faqe, ngase ato materiale që publikohen në bazë të rregullores së punës, duhet të publikohen me kohë. Vëmendja e publikut, tha z. Vishi, për punën e KQZ-së përqendrohet më shumë në periudhat zgjedhore, dhe ne duhet të ofrojmë informim me kohë. E dyta, ka të bëjë me materialet zgjedhore – formulartë...! Jemi në fillim të aktiviteteve, dhe ato, sa u përketë materialeve, fillojnë pas miratimit të buxhetit – dhe pas zotimit të mjeteve financiare. Sekretariati, ka punë intensive në aktivitetet prokuruese, duke i marrë parasysh edhe afatet e shkurtra, dhe është mirë që materialet të kalojnë nëpër këshilla, para se të shkojnë në shtyp...

Z. Vishi, në kontekst, elaboroi veçanërisht çështjen e “Formularit...”, duke pasur si shkas – fakt, problemin që ndodhi me formularin në zgjedhjet e 6 tetorit, 2019.

**Alim Rama:** Pajtohem, dhe ndoshta KQZ duhet me ba praktikë që të gjitha dokumentet sensitive e me u aprovua prej këshillave, dhe në fund prej KQZ –së, posaçërisht kur vjen puna te Fletëvotimi dhe Formularët...

A ka dikush tjetër lidhur me këtë temë...?

Nëse jo, e mbyllim mbledhjen. Faleminderit...









